



E nderuara vizitore, i nderuari vizitor,

Së bashku me Anëtarët e Këshillit të Fondacionit ISEAL, ju dëshiroj mirëseardhje në faqen e Internetit të Institutit Zviceran të Studimeve Shqiptare – ISEAL. Instituti ka për synim të parë, sipas statuteve të tij, të zhvillojë dhe të përforcojë lidhjet në mes të Zvicrës dhe Shqiptarëve, të përkrahë integrimin e Shqiptarëve në Zvicër.

Shqiptarët : çfarë dimë ne, ne të tjerët Zviceranë, për këtë komunitet që numëron më shumë se një çerek milioni persona në vendin tonë, që kontribuon në masë madhore në punën e shumë sektorëve, çelës të ekonomisë tonë ? As Latinë, as Sllavë, as Turq, as Grekë : po kush janë pikërisht Shqiptarët ? Përtej kontakteve profesionale që ne mund të kemi me Shqiptarët në përditshmëri, çfarë dimë ne për ata, për kulturën e tyre, për prejardhjet e tyre ? Çfarë dinë ata për ne, për institucionet tona ?

Pikërisht në shtrim të këtyre pikëpyetjeve, Instituti Zviceran i Studimeve Shqiptare – ISEAL, ka përqendruar synime që të zhvillojë dhe përforcojë lidhje në mes të Zvicrës dhe Shqiptarëve, sepse një njohje e ndërsjellë nuk mundet të jetë tjetër përveç se përkrahje e integritit.

Në aktivitetet e saja ISEAL-i nuk nënkupton të zhvillojë kërkime në një *kullë të fildishtë* por do të kontribuojë me rezultate konkrete.

Me këtë rast i falënderoj Autoritetet dhe Institucionet që na përkrahin në ecjen tonë. Këto mbështetje janë vendimtare për të na mundësuar që të ecim para.

Falënderimet e mia shkojnë gjithashtu edhe për Shoqatën e Miqve të ISEAL-it, e fuqishme me afër 150 anëtarë, për mbështetjen e tyre.

Shpresoj se lundrimi në faqen e Internetit të ISEAL-it do të jetë për Ju i dobishëm dhe e këndshëm.

Mos ngurroni të na kontaktoni nëse keni sugjerime, vështrime apo pyetje.

Ju falënderoj për vizitën tuaj.

Francis Cousin
Kryetar i Këshillit të Fondacionit **ISEAL**